

V E N D I M
Nr. 532, datë 5.10.2000

**PËR MIRATIMIN E STUDIMIT “STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR
BIODIVERSITETIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 38, të ligjit nr.7664, datë 21.1.1993, “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e studimit, që i shërben porgramit të qeverisë, “Strategjia dhe plani për biodiversitetin”, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Për të ndjekur zbatimin e studimit e të rekomandimeve të tij krijohet Këshilli Kombëtar për Natyrën dhe Biodiversitetin, me këtë përbërje:

- Zëvendëskryeministri dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale	kryetar
- Kryetari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit	sekretar
- Ministri i Mbrojtjes	anëtar
- Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit	anëtar
- Ministri i Punëve Publike	anëtar
- Ministri i Financave	anëtar
- Ministri i Arsimit dhe Shkencës	anëtar
- Ministri i Pushtetit Lokal	anëtar
- Kryetari i Komitetit të Turizmit	anëtar
- Kryetari i Akademisë së Shkencave	anëtar
- Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik	anëtar
- Përfaqësues i OJQ-ve mjedisore	anëtar

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit të mbulojë shpenzimet e këtij këshilli.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta